



Prishtinë, 24.06.2022  
Kodi i ZRRE-së: V\_1536\_2022

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2292\_03\_22** i dt.21.03.2022;
- Ankesa e konsumatorit e datës 13.04.2022.

### në seancën e mbajtur më datë 24.06.2022 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit RR.H nga komuna e Drenasit;
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2292\_03\_22, i datës 21.03.2022.

## A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 21.03.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2292\_03\_22 me të cilin e ka refuzuar ankesën e palës mbi kontestimin e pergjigjes së KESCO-s lidhur me korrigjimin plotësues 95819DPR-90048327 datë 23.10.2020, për shkak të matjes jo të saktë të njehsorit elektrik nr.12359694.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori RR.H, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRrE-së, ku ka kërkuar:

- Shqyrtimin e ankesës në përpikmëri, për borxhin me të cilin është ngarkuar në shumë prej 111.83 Euro dhe verifikimin e njehsorëve që kanë llogaritur kilovatë me numër të lartë krahas njehsorit që i është vendosur së fundi në shtyllën jashtë oborrit të shtëpisë.
- Potencon se njehsorët kanë dallime të larta në llogaritjen e kilovatëve në periudha mujore.
- Konstaton se nuk ka asnjë pajisje elektrike e cila do të ndikonte në shpenzim të lartë të kilovatëve.
- Kërkon nga Bordi që kërkesa e tij të aprovohet me vendim të drejtë.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi pas analizimit të të gjitha provave dhe shkresave të nevojshme, e në vecanti: Ankesën e konsumatorit të datës 23.10.2020, Vendimin e KESCO-s të datës 01.12.2020, Rrjedhën e energjisë elektrike, Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0823613 datë 19.11.2019, Protokollin e shqyrtimit të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 890 datë 08.10.2020, Ankesën e konsumatorit të datës 04.06.2021, Vendimin e DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2292\_03\_22** i datës 21.03.2022 dhe Ankesën e datës 13.04.2022, ka ardhur në përfundim se ankesa e konsumatorit është e pabazuar dhe Vendimi i DMK-së mbetet në fuqi si vendim i ligjshëm.

Bordi pas analizimit të të gjitha dëshmive të paraqitura nga ana e konsumatorit dhe të licencuarit KESCO, ka vërejtur se, fillimisht me datë 19.11.2019 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar shpenzimet e regjistruara në njehsorin elektrik nr. 12359694 me gjendje TL=063177 kËh dhe TU=041215 kËh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal që gjatë inspektimit kanë hasur në lidhje e cila e anashkalon njehsorin elektrik e cila është bërë në kuadrin kryesor kyçës. Lidhja është bërë me kabull S=5x2.5 mm. Ekipi i KEDS-it po ashtu ka evidentuar pajisjet të cilat kanë qenë duke u furnizuar nga kjo lidhje, si dhe kanë evidentuar se behët eliminimi i lidhjes. Më tutje me datë 19.11.2019 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 12359694 me gjendje TL=063177 kWh dhe TU=041215 kWh si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 20044661 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar se njehsori nr. 12359694 nuk benë matjen e shpenzimit në "L1" si dhe që duhet të dërgohet në qendrën e kalibrimit për shqyrtim. Me datë 08.10.2020 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 12359694 me gjendje të shpenzimeve TL=063177 kWh dhe TU=041212 kWh ku kanë konstatuar se: njehsori elektrik bllobat (vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori elektrik dëmtime nuk ka. Në brendi të njehsorit ka vërejtur se: Sistemi i fazës së parë R është i djegur dhe si pasojë njehsori elektrik regjistron energji elektrike për **33%** me pak. Duke u mbështetur në këto të dhëna dhe procesverbale, Departamenti i faturimit në KESCO me datë 23.10.2020 e ngarkon konsumatorin me korrigjim plotësues 95819DPR-90048327 në vlerë financiare **111.83€** duke bërë korrigjimin plotësues për faturat e periudhës 05/2019-10/2019. Në shenjë pakënaqësie konsumatori parashtron ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar korrigjimin plotësues. Ndërkaq, KESCO i përgjigjet konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 890 datë 08.10.2020. I pakënaqur konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar ti shqyrtohet korrigjimi plotësues 95819DPR-90048327 datë 23.10.2020, por kërkesa e tij është refuzuar edhe nga DMK-ja.

Bordi, pas shqyrtimit të të gjitha këtyre shkresave dhe bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik si dhe njehsorin e ri elektrik konstaton se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore dhe se ne asnjë rast nuk lexuesi nuk ka evidentuar që njehsori elektrik është i dëmtuar në çfarëdo forme përveç se në disa periudha ka evidentuar se nuk ka qasje në leximin e pikës matëse .



Ndërkaq, sa i përket kërkesës së konsumatorit për verifikimin e njehsorëve të vjetër dhe atij që i është vendosur së fundi, Bordi sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike për periudhat kontestuese si dhe më të hershme me njehsorin e vjetër elektrik nr. 12359694 dhe njehsorët e ri elektrik nr. 20044661, nr. 75153607 dhe nr. 55688185 për periudha të njëjta kohore, konstaton se ka ndryshim të shpenzimeve, ka rritje të shpenzimit pas ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 12359694 me njehsorin nr. 20044661 si dhe ka dallim në shpenzime në mes njehsorit nr.75153607 dhe njehsorit nr. 55688185.

Bordi është ndalur edhe në analizimin e Rrjedhës së energjisë elektrike, sipas së cilës mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr. 12359694 për periudhën 06/2017 deri në periudhën 11/2017 është **795 kWh/muaj**, periudhën 06/2018 deri në periudhën 11/2018 është **1,201 kWh/muaj**, periudhën 06/2019 deri në periudhën 11/2019 është **939 kWh/muaj**, me njehsorin e ri elektrik nr. 75153607 periudha 06/2020 deri në periudhën 11/2020 është **1,005kWh/muaj** si dhe me njehsorin nr.55688185 për periudha 06/2021 deri në periudhën 11/2021 është **475 kWh/muaj**. Bordi ka krahasuar edhe shpenzimet në mes njehsorit nr. 20044661 dhe njehsorit kontestues nr.12359694 për periudha të njëjta dhe konstatohet se ka ndryshim në shpenzim. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr. 12359694 për periudhën 12/2018 deri në periudhën 05/2019 është **1,025 kWh/muaj** kurse me njehsorin nr. 20044661 për periudhën 12/2019 deri në periudhën 05/2020 është **1,347 kWh/muaj**. Bazuar në krahasimet e bëra konstatohet se konsumatori ka ndryshim në shpenzimet e regjistruara me katër njehsorët elektrik.

Bordi më tutje ka shqyrtuar korrigjimin plotësues të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe konstaton se KESCO ka vepruar bazuar në procedurat dhe kodet në fuqi sipas së cilave në rastet kur konstatohet se ka defekt në sistemin matës atëherë duhet të bëhen të gjitha korrigjimet e nevojshme duke bërë ri llogaritjen e energjisë përkatësisht përmirësimi i faturimit e që për konsumatorët komercial përfshin periudhën një vjeçare kurse konsumatorët shtëpiak periudhën gjashtë mujore.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Ymer Fejzullahu, Kryesues

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

---

Lutfije Dervishi, anëtare

---

Gani Buçaj, anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KESCO-s,
- Konsumatorit RR.H dhe
- Arkivit të ZRRE-së.